



DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E TATIMEVE



European Bank
for Reconstruction and Development

Ky material është përgatitur në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe përmban informacion mbi të drejtat dhe detyrimet tatimore për kategorinë:

Fermerët

Qendra e thirrjeve: 0800 00 02 (pa pagesë).

Orari: E Hënë - E Enjte ora 08:30 - 18:00; E Premte ora 08:30 - 16:00

 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Web: www.tatime.gov.al



European Bank
for Reconstruction and Development



DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E TATIMEVE

INFORMACION PËR TATIMPAGUESIT

Fermerët

PËR FERMERIN

1. Quresh Fermer nëse:

- Je banor atje ku zotëron tokë bujqësore në pronësi ose në përdorim;
- Zhvillon veprimtari bujqësore e blegtorale si bujk privat, i vetëpunësuar në tokën tënde;
- Nuk je i regjistruar si person fizik ose juridik.

2. Që të përfitosh kompensimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) të paguar dhe subvencione nga Qeveria, regjistrohu tek Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT):

- Paraqitu fizikisht dhe dorëzo një formular me të dhënat e mëposhtme:
 - Dokumentin e identitetit;
 - Një vërtetim nga Drejtoria e Bujqësisë për ushtrimin e veprimtarisë si bujk privat;
 - Të dhëna personale dhe të biznesit (adresa, telefoni, vendi dhe fusha e veprimtarisë, etj.).
- Dhe merr dokumentin e identifikimit (brenda dy ditëve pas kërkesës), që quhet Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT), dhe certifikatën përkatëse të regjistrimit si fermer ku shënohen të dhënat e biznesit.

Kujdes:

Nëse pas regjistrimit fillestar i ndryshon të dhënat, njofto DRT ku je regjistruar.

3. Regjistrimi në DRT të garanton rimbursimin/kompensimin nga blerësit apo grumbulluesit të 6% të shumës së faturës së produkteve të shitura, nëse:

- Shet prodhimin tënd tek tregtari dhe grumbulluesi i produkteve bujqësore, blegtorale dhe të peshkimit, i cili është i regjistruar për pagimin e TVSh-së;
- Ke lidhur paraprakisht një marrëveshje me ta për shitjen e prodhimit;
- Shet vetëm produkte të prodhuara si bujk privat, me punën tënde dhe të familjes;
- Firmos dhe merr një kopje të faturës tatimore me TVSh ku është shënuar NIPT-i yt, sasia, çmimi dhe vlera e prodhimit të shitur;
- Blerësi ka shtuar në faturën tatimore me TVSh edhe 6% mbi çmimin e blerjes, e cila është shuma që do të kompensohet nga grumbulluesi ose tregtari;
- Nuk je subjekt i pagimit të TVSh-së dhe me anë të këtij kompensimi realizohet kthimi mbrapsht i TVSh-së që ti e ke paguar në blerje për mallrat dhe shërbimet që përdor për kryerjen e aktivitetit tënd prodhues, bujqësor, blegtoral apo të peshkimit.

Kujdes:

- Për arkëtimin nga blerësi të shumave mbi 30 mijë lekë, kompensimi të jepet vetëm nëse ato i bën nëpërmjet sistemit bankar ose shërbimit postar;
- Kur shitjet vjetore e kalojnë shumën 5 milionë lekë në vit, kompensimi të ndërpritet sepse duhet të regjistrohesh si biznes i vogël dhe bëhesh subjekt i pagimit të TVSh-së dhe detyrimeve të tjera tatimore;
- NIPT-i vlen dhe duhet përdorur për shitjet tek blerësi vetëm të produkteve të tua;
- Kur nuk kryen aktivitet, dorëzo NIPT-in në DRT dhe çregjistrohu si fermer.

4. Për të përfituar pension (pleqërie, invaliditeti dhe familjar), dhe pagesë për lindje fëmije regjistrohu tek Agjencia e Sigurimeve Shoqërore (ASSh):

- Nëse je:
 - I aftë për punë;
 - I vetëpunësuar në bujqësi dhe i pasiguruar nga punësimi në sektorë të tjerë;
 - Mbi moshën 16 vjeç.
- Duke paraqitur:
 - Certifikatën familjare;
 - Vërtetimin e pronësisë mbi tokën ose të së drejtës së përdorimit të saj;
 - Kontratën e qeramarrjes së tokës bujqësore;
 - Vërtetim të Njësisë Administrative Bashkiake për ushtrimin e veprimtarisë si bujk privat.

Kujdes: Dokumentat janë personale, paraqiten por nuk dorëzohen tek nëpunësi i ASSh-së.

- Merr librezën e pagesës së kontributeve mbasi të kesh:
 - Marrë dokumentin "Urdhër-Vepim", që tregon shumën që duhet të paguash;
 - Kryer pagesën e kontributeve në një zyrë postare ose bankare;
 - Paraqitur në ASSh dokumentin që konfirmon kryerjen e pagesës së kontributeve.

5. Marrja e përfitimeve kushtëzohet me pagesën e kontributeve

Shuma e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që do të paguash ndryshon me ndryshimin e pagës minimale mbi të cilën llogaritet. Për vitin 2018 shuma e pagesës është si më poshtë:

Tabela 1 – Kontributet vjetore të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore të Fermerëve për vitin 2018
(sipas VKM Nr. 77, datë 28.1.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore dhe Sigurimi i Kujdesit Shëndetësor", i ndryshuar)

Ndarjet Administrative	Sigurime Shoqërore	Sigurime Shëndetësore	Totali
Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë.	29,400	3,768	33,168
Berat, Kuçovë, Durrës, Krujë, Elbasan, Peqin, Fier, Lushnjë, Mallakastër, Gjirokastrë, Përmet, Korçë, Pogradec, Devoll, Lezhë, Laç, Shkodër, Tiranë, Kavajë, Vlorë, Sarandë dhe Delvinë.	38,400	3,768	42,168

6. Kontributet paguhen në sistemin bankar ose shërbimin postar:

- Një herë në tre muaj, në ditën e fundit të muajit të tretë të çdo tremujori.

7. Nëse kontributet nuk paguhen në afat, je i pasiguruar dhe paguan kamatëvonesë:

- Në masën 120% të interesit ndërbankar, nga lindja e detyrimit deri në datën e pagesës.